

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“READ 2000” Sh.P.K

Mbështetur në kushtetutën dhe Kodin Civil në Shqipëri, bazuar në Ligjin Nr.9901,date 14.04.2008”PER TREGTARET DHE SHOQERITE TREGTARE “NDRYSHUAR ME Ligjin Nr.10 475,date 27.10.2011 Per nje ndryshim ne Ligjin Nr.9901, date 14.04.2008 PER TREGTARET DHE SHOQERITE TREGTARE “ DHE LIGJIT Nr.9723, date 03.05.2007 per Q.K.R unë i nënshkruari ortaku I vetem Z. Xhafer Kodra, i datëlindjes 15.09.1952 lindur në Tresove, Korce, me vullnetin tim të lirë,të shprehur edhe në nëshkrimin e këtij akt-themelimi sot ne daten **15.05.2017** vendos të krijojë shoqërinë tregtare me përgjithësi të kufizuar “READ 2000” Sh.P.K me akt themelimi si vijon:

Formulimi

Neni 1

Formohet shoqëria private e quajtur “READ 2000” Sh.P.K do të ketë selinë në Tiranë , Rr. “ Shkelqim Fusha” Zona Kadastrale 3292, Vol. 734, fq. 88, me nr. Pasurie.104/87-G12, njesia administrative Nr.5.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë , të krijojë filiale si Brenda ashtu dhe jashtë Republikës së Shqiperise , vetëm me vendim të asamblesë dhe ortakut të vetëm .

Objektivi I Veprimtarisë

Neni 2

Shoqëria tregtare ushtron veprimtarinë: **Import – Eksport, Tregtim pajisje zyre, kancelarie, kompjutera, tonera, fotokopje, shitje kompjuterash, pjese per printera dhe fotokopje, servis kopjutera, printera, fotokopje, agjenci turistike, etj.**

Neni 3

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jete me nje afat 20-vjeçar . Afati I veprimtarisë së shoqërisë, mund të ndryshojë, me vendim të shoqërisë.

Neni 4

Kapitali I Shoqërisë

Kapitali fillestar I shoqërisë private “READ 2000” sh.p.k do të jetë 100.000 (njëqind mijë lekë).Kapitali është 100% nga kuota e ortakut të vetëm, e ndarë në në 1 kuotë . Kapitali themeltar fillestar mund të shtohet ose të pakësohet (por jo nën vlerën e kapitalit themeltar fillestar).

Drejtimi I Shoqërisë

Neni 5

Shoqëria do të drejtohet nga administratori i saj , përfaqesuesi ligjor i saj . Ai është përfaqesuesi i Shoqërisë në marrëdhënie me të tretët dhe ka kompetenca të plota në drejtimin e saj .

Çdo kontratë do të kryhet prej tij dhe ne rast mungesë nga një përfaqësues i pajisur me prokurë të posaçme .

Neni 6

Fitimi që do të rezultojë nga veprimtaria e shoqërisë i takon tërësisht ortakut të vetëm të saj. Shoqëria nuk përgjigjet për humbjet e ortakut të saj jashtë veprimtarisë së shoqërisë.

Neni 7

Ortaku i vetëm themelues ka te drejtë të emëroje dhe administratorë të tjerë të vlerave materiale. Ka te drejtë te caktojë financiarë , likuidator për problemet e shoqërisë si dhe të pajtojë persona të tjerë,si ortakë .

Neni 8

Konfliktet që mund te lindin do të zgjidhen në zbatim te legjislacionit Shqipëtar në Gjykatën e Rethit Gjyqësor Tiranë .

Neni 9

Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje me legjislacionin Shqipëtar në fuqi .

Neni 10

Akti I themelimit u përpilua në 4 kopje , për t'ju shpërndarë organeve kompetente dhe një kopje do të mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë “READ 2000” Sh.P.K.

Akti I themelimit nënshkruhet rregullisht nga ortaku i vetëm .

Ortak i vetëm themelues i

“READ 2000” Sh.P.K

Xhafer Kodra



STATUT

I

I SHOQËRISE ME PËRGJITHESI TË KUFIZUAR “READ 2000”

KREU I

EMËRIMI, OBJEKTIT I VEPRIMTARISË, SELIA, KOHËZGJATJA

Neni 1

EMËRTIMI

Mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Kodin Civil në Shqipëri, bazuar ne Ligjin Nr.9901, datë 14.4.2008 PËR TREGTARËT DHE SHOQËRITË TREGTARE, ndryshuar me Ligjin Nr.10 475, datë 27.10.2011 Per nje ndyshim ne Ligjin Nr.9901, DATË 14.4.2008 "PËR TREGTARËT DHE SHOQËRITË TREGTARE" dhe ligjit nr.9723 datë 3.05.2007 për Q.K.R me vullnetin e saj te lire për të shprehur dhe në nënshkrimin e aktit të themelimit (që I bashkangjitet këtij statuti) sot me date **15.05.2017** ortaku I vetem Z.Xhafer Kodra, I datëlindjes 15.09.1952 lindur në Tresove, Korce, Krijon Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar “READ 2000” Sh.P.K.

Neni 2

Selia e shoqerisë

Selia e shoqerisë gjendet në Tiranë, Rr. “ Shkelqim Fusha” Zona Kadastrale 3292, Vol. 734, fq. 88, me nr. Pasurie.104/87-G12, njesia administrative Nr.5.

Shoqëria mund të ndryshojë seline e saj me vendim të Asamblesë së Ortakeve(ortakut të vetëm).

Neni 3

Shoqëria e zhvillon akivitetin në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe me statutin e saj, në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashte saj. Shoqëria mund të krijojë degë në vende në përputhje me legjislacionin e vendit përkatës.

Neni 4

FUSHA E AUTORITETIT TË ORTAKËVE(ORTAKUT TË VETËM)

Fusha e autortitetit të ortakëve(ortakut të vetëm) dhe përqindja e fitimeve dhe humbjeve do të kenë si kriter bazë kapitalin e shoqërisë si dhe kompetencat që gëzon në marjen e vendimeve të cdo karakteri, të percaktuara në këtë statut.

Neni 5

LIBRI I SHOQERISË

Për të precizuar e për të saktësuar veprimtarinë e vet ekonomike si dhe marrëdhëniet e punës, shoqëria do të çelë librin e vet, i cili do të quhet libri i shoqërisë.

Neni 6

KONFIDENCIALITETI

Ortakët(ortaku i vetëm), si dhe personat e tjerë të pranuar në shoqëri, bien dakord që të mos I ekspozojnë asnjë personi të jashtëm informacionet që do të disponojë shoqëria, kontratat që ajo do të lidh, si dhe planet ose qëllimet që ajo ka për të ardhme e saj.

Neni 7

Te gjithë aktet dhe dokumentet që nxirren nga shoqëria dhe të destinuara për të tretët, si: letrat, faturat, lajmerimet dhe publikimet e ndryshme etj, duhet të tregojnë lexueshëm: emrin e shoqërisë dhe pas tij fjalet- shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, ose inicialet-sh.p.k dhe emrin e administratorit.

Neni 8

Shoqëria tregtare ushtron veprimtarinë: Import – Eksport, Tregtim pajisje zyre, kancelarie, kompjutera, tonera, fotokopje, shitje kompjuterash, pjese per printera dhe fotokopje, servis kopjutera, printera, fotokopje, agjenci turistike, etj.

Neni 9

KOHËZGJATJA

Jetëgjatësia e shoqërisë do të jete 20 vjet, por ajo mund të shpërndalet edhe para këtij afati të përcaktuar më sipër me vendim të Asamblesë së Ortakëve(Ortaku i vetëm) të shoqërisë, si dhe kur merr fund aktiviteti i saj apo kur shpërndarjen e saj e përcakton ligji.

KREU

Neni 10

KAPITALI THEMELTAR, KUOTAT

Kapitali themeltar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është 100.000 (njqind mije) lekë. Shoqëria mund të shtojë ose pakesojë kapitalin e saj deri në limitin e përcaktuar me ligj, me vendim të Asamblesë së Ortakëve(ortakut të vetëm). Kapitali themeltar përbëhet nga kontributi i mëposhtem: 100.000 (njqind mije) lek ose 100% të kapitalit themeltar e ndarë në 1 kuotë.

Neni 11

Lënia dhe transferimi i pjesëve të kapitalit: Kapitali themeltar është lirisht i transferueshem tek personat e tretë, n.q.s Asamblea e miraton.

Neni 12

Asamblea e Ortakëve(Ortaku I vetem), miraton llogaritë, nëse është e nevojshme pas raportit të eksperteve kontabël të autorizuar brenda 6 muajve nga mbyllja e vitit financiar, merr vendim për ndryshimet që mund të pësoje statuti, për ndryshimin e masës së kapitalit themeltar dhe shdnërrimin e shoqërisë ne një formë tjetër, për punësimin e punonjësve dhe pagat, si dhe problem të tjera të lidhura me punësimin në zbatim të legjislacionit shqiptar etj. Vendimet e Asamblesë së ortakëve(Ortaku i vetëm) evidentohen ne një regjistër.

ORGANET DREJTUESE

Neni 13

Organi vendimor i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "READ 2000" Sh.P.K është Asamblea e Ortakëve(Ortaku i vetëm) të shoqërisë, e cila zgjedh administratorët që do të hyjnë në marrdhënie me të tretët.

Neni 14

Shoqëria, drejtohet nga **administrator në funksion që kryhet nga Xhafer Kodra** të cilit I atribuohen të gjithë kompetencat , përveç atyre të cilat ligji ia nje shprehimisht Asamblesë së Ortakëve(Ortaku i vetëm).

Neni 15

LIBRAT E SHOQERISË, BILANCI, SHPËRNDARJA DHE LIKUJDIMI

Shoqëria është e detyruar të mbajë përveç dokumentacionit kontabël ose librave të tjerë edhe:Librin e shoqërisë në të cilin shënohet: Emrat e Ortakeve, kapitali themeltar si dhe vendimet e Asamblesë (Ortakut të vetëm).

Neni 16

PUNËSIMET NË SHOQËRI

Për punonjësit që do të punësohen, marrëdhëniet juridike midis shoqërisë dhe te punësuarve do të rregullohen me kontratën e punës në përputhje me dispozitat ligjore dhe Kodin e Punës.

Neni 17

Shoqëria merr përsipër të derdhë rregullisht të gjitha detyrimet, gjithashtu dhe kontributet për sigurimin e të punësuarve të saj në organet kompetente përkatëse sipas ligjit.

Neni 18

BILANCI

Shoqëria është e detyruar të dorëzojë bilancin brenda afateve të caktuara në ligjin mbi Kontabilitetin.

Neni 19

SHPËRNDARJA DHE LIKUJDIMI

Shoqëria mbaron me vendim të Asamblesë së Ortakeve(Ortakut të vetëm) ose kur ka një prishje të parakoheshme për arsyet e parashikuara në ligj.

Neni 20

Shoqëria hyn në procesin e likujdimit që në momentin e prishjesh së saj. Për kryerjen e këtij procesi, Asamblea e Ortakeve (Ortaku i vetëm) cakton një ose disa likujdator, të cilet I paraqesin asaj raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe të pasivitetit të shoqërisë, mbi ndjekjen e operacioneve të likujdimit dhe mbi afatin e nevojshem të përfundimit te tyre. Në fund të procesit të

likujdimit,Asamblea e Ortakeve(Ortaku i vetëm) vendos mbi bilancin përfundimtar financiar dhe mbi mbylljen e procesit të likujdimit. Pas pagimit të likujdatoreve, Asamblea e Ortakeve(Ortaku I vetëm) mban pjesën e mbetur të kapitalit.

Neni 21

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Të gjithë mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ekzistences së shoqërisë ose gjatë periudhes së likujdimit, do ti paraqiten për zgjidhje gjykatës kompetente.

Neni 22

DISPOZITAT E FUNDIT

Ky statut u hartua në katër kopje në gjuhën Shqipe, duke patur secila kopje fuqi të njëjtë ligjore. Përsa nuk është shprehur në këtë statut, do të bazohet ligji “PËR TREGTARËT DHE SHOQËRITË TREGTARE”(me ndryshimet përkatëse) dhe Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë që është në fuqi.

**Ortak i vetëm themelues i
“READ” Sh.P.K**

Xhafer Kodra

